



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINË *MUNICIPALITY ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINE PRISHTINA

Në bazë të nenit 14, të Ligjit mbi tokën ndërtimore ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 14/80 dhe 42/86), nenit 3, al. 1, pika "b" të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45 të dt. 11 gusht 2000, nenit 7, të Rregullorës për dhënie të tokës ndërtimore në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin-vendosjen e objekteve të përkohshme nr. 01.-01.-2 të datës 03.01.2002 dhe nenit 19, al. 1, pika "b" të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 20.02.2004 merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT DHE DHËNIEN E TOKËS NË SHFRYTËZIM TË
PËRKOHSHËM SHOQATËS SË GRAVE "BULËZA" PËR VENDOSJEN E
OBJEKTIT ME KARAKTER TË PËRKOHSHËM

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e objektit të përkohshëm në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 6219, Komuna Kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe prej 6 m², (2, 4 mx 2, 4 m sipas standardeve), sipërfaqe publike.

Lokacioni, nga alinea 1 e këtij neni, gjindet në platon përbri objektit të KEK-ut dhe afër dy kalimeve nëpër objektet banesore bri kësaj platoje, i prezentuar në situacionin e gjerë të lokacionit, në përpjesë 1:1000, e që paraqitet si pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 2

Lokacioni, nga neni 1. i këtij Vendimi, i jepet në shfrytëzim të përkohshëm shoqatës së grave "Bulëza", në kohëzgjatje prej 1 viti, me mundësinë e vazhdimit të kësaj të drejte edhe pas kalimit të këtij afati. Mënyra, të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga shfrytëzimi i lokacionit, të caktuar sipas këtij Vendimi, do të rregullohen me kontratë të veçantë në mes të Komunës dhe shfrytëzuesit.

Neni 3

Kushtet urbanistiko-teknike dhe lejinin e vendosjes së objektit në lokacionin e caktuar sipas këtij Aktvendimi, i cakton Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër i Komunës së Prishtinës është përgjegjës për kryerjen e veprimeve procedurale nga përgjegjësia e tij për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës

Neni 5

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe pjesa grafike e situacionit të lokacionit nga neni 1 i këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi dhe aplikohet ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR.353-368 DT. 26.02.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri